

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), si dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëria LG Elektroniks Ink (LG Electronics Inc), me seli të regjistruar në 128, Jeoyi-daero, Jeongdeyngpo-gv, SAeul, Republika e Koresë dhe shoqëria SM Enterteinment Ko. Ltvd. (SM Entertainment Co.Ltd.), me seli të regjistruar në 83-21, Vangsimni-ro, Seongdong-gv, Seul, Republika e Koresë i dorëzuar përmes Bozhidar Millosheviq, avokatë nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 02.03.2022, merr këtë:

### **AKTVENDIM**

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet krijimit të një ndërmarrje plotësisht funksionale e cila do të jetë aktive me aplikacione fitnesi nga shoqëria LG Elektroniks Ink (LG Electronics Inc), me seli të regjistruar në 128, Jeoyi-daero, Jeongdeyngpo-gv, SAeul, Republika e Koresë dhe shoqëria SM Enterteinment Ko. Ltvd. (SM Entertainment Co.Ltd.), me seli të regjistruar në 83-21, Vangsimni-ro, Seongdong-gv, Seul, Republika e Koresë edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksë administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

### **Arsyetim**

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, më 27.01.2022, i plotësuar më 31.01.2022, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni)

u dorëzua një njoftim për përqendrim që i referohet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët plotësisht funksionale nga shoqëria LG Elektroniks Ink (LG Electronics Inc), me seli të regjistruar në 128, Jeoyi-daero, Jeongdeyngpo-gv, SAeul, Republika e Koresë dhe shoqëria SM Entertainment Ko. Ltd. (SM Entertainment Co.Ltd.), me seli të regjistruar në 83-21, Vangsimni-ro, Seongdong-gv, Seul, Republika e Koresë.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim, shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

### **Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

**LG Elektroniks Ink.** është një prodhues dhe furnizues në nivel botërorë i elektronikës, pajisjeve celulare për komunikim dhe aparateve shtëpiake, me rreth 76.000 punonjës në 142 vende të ndryshme të botës. Të ardhurat botërore të LG Elektroniks Ink në vitin 2020 ishin 47.4 miliardë dollarë. LG Elektroniks Ink. e zhvillon veprimtarinë e saj nëpërmjet katër njësive të biznesit: Home Entertainment:HE, Business Solutions:BS, HomeAppliance & Air Solutions:H&A dhe Vehicle Components:VC.

LG Elektroniks Ink nuk është e pranishme drejtpërdrejtë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por ka të ardhura të realizuara nga shitjet indirekte në Republikën e Maqedonisë së Veriut. LG Elektroniks Ink është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet shitjes indirekte nga shoqëria e tyre e varur në Hungari. Portofoli i produkteve që shiten në Maqedoninë e Veriut përfshin elektronikë dhe pajisje për konsumatorë, p.sh. televizor, lavatriçe, enëlarëse, frigoriferë, monitorë, kondicionerë, altoparlantë projektorë, kinema shtëpiake etj.

SM Entertainment Ko. Ltd. është një kompani udhëheqëse aziatike për argëtim, e themeluar në vitin 1995 me rreth 1700 punonjës në mbarë botën. Në vitin 1997 u bë kompania e parë në industrinë koreane të argëtimit e cila hyri në tregjet e huaja. SM Entertainment Ko. Ltd ka hyrë me sukses në Amerikën e Veriut, Amerikën e Jugut dhe Evropën, duke ruajtur ende bazën e saj në Azi dhe ka përmirësuar markën kombëtare të Koresë. SM Entertainment Ko. Ltd. promovon kulturën unike të Koresë përmes K'POP, alfabetit korean dhe kuzhinës koreane përmes përmbajtjes "Krijuar nga SM" ("Made by SM") në mbarë botën". SM Entertainment Ko. Ltd. nuk ka regjistruar shoqëri të varura në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por ka realizuar të ardhura të papërfillshme në Maqedoninë e Veriut në vitin 2020 dhe 2021 nga shitjet direkte

Aktivitetet e parashikuara të biznesit të Ndërmarrjes së përbashkët do të përfshijnë si vijon:

- operim të një platforme që ofron përmbajtje, shërbime dhe produkte në lidhje me fitnesin;
- planifikim dhe krijim të përmbajtës në lidhje me fitnesin;
- operim në një studioje lidhur me fitnesin;
- punë afariste, rastësore ose lidhur me çdo gjë që u tha me sipër

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

#### **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**Prof. Dr. Владимир Наумовски**